



Në mbëshitetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 11 paragrafi 4 të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit, me datë 28.05.2024, nxjerrë këtë:

VENDIM

DPKI	763/24
05	30.05.24

- I. Mbylljet rasti APK-DPKI-06-387/24, për ish - zyrtarin e lartë z. Nuredin Abazi, ish - Gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, tani Avokat në Suharekë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit.

Arsyeshim

Rasti i hapur nën dyshimin për kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike për ish - zyrtarin e lartë z. Nuredin Abazi, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga Jashtë - raportuesi i rastit (DPKI-387/24), me të cilën është kërkuar inicimi i procedurës për vlerësimin e konfliktit të interesit ndaj z. Nuredin Abazi, ish - Gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prizren (në vijim: GJTH në Prizren) - Dega në Suharekë, tani avokat në Suharekë, pasi që sic theksohet në raportimin e rastit, *(ish)zyrtari në fjalë pa kaluar periudha dy (2) vjeçare pas përfundimit të funksionit publik si gjyqtar, tani në cilësi të avokatit merr autorizime dhe përfaqeson palet (e njëjta) në kontest pronësor për të njëjtën paluajtshmëri (e ndarë në dy ngastrë) që ka marrë pjesë si gjyqtar pronë kësaj gjykate*. Tuttje në kërkësë, raportuesi i rastit pretendon se përfaqësimi i palëve në kontestin si më lartë [C.nr.1260/22], nga ana e ish zyrtarit të lartë z. Nuredin Abazi, është në kundërshtim me nenin 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të LPKI-së.

Agjencia për Parandalimin e Korruptionit (në vijim: Agjencia) konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e

Korrupsionit, ka trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit sipas dispozitiveve të LPKI-së, përkatësisht vetëm pretendimet që lidhen me dyshimin për kufizimet e ish - zyrtarit të lartë z. Nuredin Abazi, pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike si gjyqtar në GJTH në Prizren - Dega në Suharekë, sipas nenit 18 të LPKI-së.

Agjencia nuk ka trajtuar pretendimet për kufizime apo ndalesa (eventuale) që mund të ketë z. Nuredin Abazi, vështruar nga veprimtaria e avokatit që e ushtron, pasi që këto pretendime janë jashtë sferës së konfliktit të interesit dhe si të tilla nuk janë në mandat të Agjencisë.

Kësisoj, Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-515/24, e ka njoftuar ish - zyrtarin e lartë z. Nuredin Abazi, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, zyrtari në fjalë është njoftuar edhe me pretendimet e ngitura për konflikt të interesit dhe faktet për rastin e tij. I njëjtë ka dërguar në Agjenci përgjigjen me shkrim përfshirë dokumentacionin relevant (DPKI-515-1/24), duke u përgjigjur për pretendimet e ngitura.

z. Nuredin Abazi, në shkresën e tij, ndër të tjera ka deklaruar se, citojmë nga deklarata e tij: “*[...] J 1999 jam inkadruar në punë dhe detyrat e punës në ish Gjykatën Komunale në Suhareke si gjyqtar per Kundervajtje deri në vitin 2007, kur kam kaluar si gjyqtar në departamentin civil, ndërkaq nga viti 2009 jam zgjedhur Kryetar i Gjykatës deri në përfundimin e detyrës kur edhe jam pensionuar me dt. 04.01.2022. [...] Para përfundimit të mandatit kam pasur në procedurë lëndën për vërtetimin e pronesisë C.nr.439/19 të paditësit A. B. ndaj të paditurit H. B. [...] e që nga kjo lëndë për shkak të kërkesës së perjashtimit tim dhe të tërë gjykatës nga i paditur, gjykata e shkalles më të lartë me Aktvendim më ka përfashtuar nga ky kontest. [...] Pas pensionimit tim me dt. 04.01.2022 [...] kam hapur avokaturën time në të cilën edhe jam duke punuar, me dt. 23.11.2022. ish pronarëti juridik të parcelës kadastrale 1183-5 [...] më kanë autorizuuar që në procedurë të ndërmjetësimit këtë parcelë [...]. Nga kjo që u tha shifet se nuk kemi të bëjmë me lëndën e njejtë siç pretendon parashtruesi i kërkesës [...], pra këtë lëndë asnjëherë nuk e kam trajtuar në procedurë gjyqësore si ish gjyqtar [...] lëndën të cilën unë e kam përfaqësuar dhe e përsaqësoj si avokat C.nr.1260/22, gjykata propozimin për caktimin e mases së sigurimit nga ana e prupozuesit ja ka refuzuar [...]*”.

Tutje në deklaratën e tij me shkrim, z. Nuredin Abazi ka theksuar se: “[...] ndaj meje si avokat [...] ka ushtruar parashtresë disiplinore në Odën e Avokatëve të Kosovës e që Oda e Avokatëve pas kërkesës së raportit nga unë lidhur më ecurinë e kësaj problematike me Vendimin nr. 96-4/2023 të dt. 26 dhjetor 2023 ka hedhë poshtë fletëparaqitjen disiplinore nr. 96/23 të dt. 01.02.2023. [...] Nga e gjitha ajo që u tha më lari mendojmë se Agjencioni për Parandalimin e Korrupsionit ka prova të bollshme dhe të bindshme për të gjykuar drejtë çështjen e cila është parashtruar për shqyrtim [...]”.

Përveç kësaj, më qëllim të sqarimit të situatës gjithnjë në kontest të zbatimit të dispozitiveve të LPKI-së dhe konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-652/24, ka kërkuar nga GTH në Prizren - Dega në Suharekë informata, sqarime dhe dokumentacionin relevant lidhur me pjesmarrjen (përfshirjen) e z. Nuredin Abazi lëndët C.nr.493/19 dhe C.nr.1260/2022. GTH në Prizren - Dega në Suharekë, duke vepruar sipas kërkesës si më lartë, ka dërguar në Agjenci informatat përmes shkresës zyrtare DPKI-717/24.

Si material plotësues në lidhje me çështjet e ngitura, GTH në Prizren - Dega në Suharekë përgjigjes ia ka bashkangjitur dokumentacionin përkatës për lëndët si më lartë.

Kësisoj, Agjencia pasi ka administruar si prova (vetëm provat që lidhen me vërtetimin e faktave - pretendimeve për konflikt të interesit) kërkesën e parashtruesit dhe dokumentacionin e bashkangjitur, përgjigjen me shkrim (deklarimin) e z. Nuredin Abazi dhe dokumentacionin e bashkangjitur, si dhe përgjigjen zyrtare të pranuar nga GTH në Prizren - Dega në Suharekë dhe dokumentacionin e bashkangjitur, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Ka qenë jo kontestues dhe fakt i pohuar nga z. Nuredin Abazi, se i njëjtë ka qenë gjyqtar në GJTH në Prizren - Dega në Suharekë, deri në më datën 04.01.2022, kur është pensionuar. Ky fakt vërtetohet edhe nga Regjistri i deklarimit të pasurisë pas largimit nga funksioni (dt. 06.01.2022) të ish - zyrtarit të lartë në fjalë.

Në cilësinë e funksionit si më lartë të cilin ka mbajtur dhe ushtruar, z. Nuredin Abazi ka pasur status të zyrtarit të lartë publik, në kuptim të nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i LPKI-së, me të cilin përcaktohet se: "Zyrtar i lartë – nënkuption zyrtarët e lartë publike të përcaktuar sipas Ligji përkatës për deklarimin, kontrollin dhe prejardhjen e pasurisë", lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.10 të Ligji Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (ligji i zbatueshëm në kohën e pensionimit), me të cilin ka qenë e përcaktuar se: "Zyrtar i Lartë Publik - janë: [...] Gjyqtarët [...]"¹.

Sipas përgjigjes zyrtare të GJTH në Prizren - Dega në Suharekë, është sqaruar se: "[...] Gjyqtari Nuredin Abazi me datë 04.01.2022, ka shkuar në pension [...] i lartëcekuri ne cilësinë e gjyqtarit ka qenë i ngarkuar me lëndën C.nr.493/21[19], ku palë paditëse është A. B., ndërsa i paditur H. B., e cila lëndë ende është ne proces gjyqësor, [...] ku objekt i këtij kontesti gjyqësor është ngastra 559-1; ngastra 1183-3; ngastra 1203-0 dhe ngastra 1204-0 [...] ish gjyqtari Nuredin Abazi në cilësinë e gjyqtarit pranë kësaj lënde ka caktuar masën e sigurisë sipas aktvendimit C.nr.493/2019 me datë 16.12.2019, e cila është vërtetuar sipas Aktvendimit te Gjykates së Apelit Ac.nr.1510/20 me datë 22.05.2020. Ndërsa që i përket lëndës tjetër C.nr.1260/2022, kjo lëndë është parashtruar në gjykatë me datë 29.11.2022, pra 11 muaj pas daljes së gjyqtarit Nuredin Abazi në pension, ku palë janë: H. B. dhe të paditur janë: F. dhe H. B. të cilët i ka përfaqësuar, tanë av. Nuredin Abazi [...]. Objekt i padisë në këtë çështje gjyqësore ka qenë ngastra 1183-5 ZK. Suharekë. Dhe ne furiq siç shihet në këto dy raste, C.nr.493/21[19] dhe C.nr.1260/2022, kanë të bëjnë me palë të njëjta në cilësi të ndryshme me objekti te kontestuar të ndryshëm apo ngastra të ndryshme. [...]".

Rrjedhimisht, z. Nuredin Abazi në cilësi të gjyqtarit ka qenë i angazhuar në rastin C.nr.493/19, deri në aktvendimin përfashtimin e tij nga procedura, por nuk ka qenë i angazhuar në lëndën C.nr.1260/2022, sepse në kohën e iniciimit të kësaj lënde ka qenë i pensionuar si gjyqtar. Ndërsa në cilësi të avokatit, ish - zyrtari i lartë në fjalë nuk ka përfaqësuar palët në lëndën C.nr.493/19

¹ Gjyqtarët kanë status të zyrtarit të lartë publik edhe në kuptim të nenit 4 paragrafi 1, nënparagrafi 1.21 të Ligjit nr. 08/L-108 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave (ligji aktual në fuqi), me të cilin është përcaktuar se: "Për qëllimet e këtij ligji, lista e zyrtarëve të lartë është si më poshtë: [...] Gjyqtarët [...]".

në të cilën ka qenë i angazhuar si gjyqtar, por ka përfaqësuar palët në lëndën C.nr.1260/2022, e cila është inicuar pasi që i njëjti është pensionuar nga funksioni i gjyqtarit.

Nga përgjigja zyrtare si më lartë dhe nga shkresat e lëndëve C.nr.493/19 dhe C.nr.1260/2022, të cilat i ka në dispozicion Agjencia, rezulton se çështja gjyqësore C.nr.493/19, në të cilën z. Nuredin Abazi ka qenë i angazhuar si gjyqtar, është e ndryshme për nga objekti i kontestit dhe për nga ngastra kadastrale, prej lëndës C.nr.1260/2022, për të cilën ish - zyrtari i lartë në fjalë ka marrë pjesë në cilësi të përfaqësuesit (avokatit) të palës.

Nga Vendimi nr: 96-4/2023, i datës 26.12.2023, konstatohet se lidhur me dyshimet për shkelje të legjislacionit për avokatinë rasti është parashtruar edhe në Odën e Avokatëve të Kosovës, por që Zyra e Prokurorit Disiplinor të kësaj ode, ka hundë fletëparaqitjen disiplinore kundër avokatit z. Nuredin Abazi, sepse siç theksohet në vendim, nuk është vërtetuar se i paraqituri të ket kryer shkelje disiplinore në raport me ushtruesin e fletëparaqitjes disiplinore, të normuar me normativën e OAK-së.

I. Në vështrim të pretendimeve dhe gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi, se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm përkthimin e konfliktit të interesit, për shkak se kufizimi pas ushtrimit të funksionit publik sipas nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të LPKI-së, nuk vlenë dhe nuk zbatohet në këtë rast.


Së këndejmi, me dispozitat e nenit 18 të LPKI-së janë paraparë kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike, konkretisht me paragrin 1, nënparagrafi 1.3 të këtij nenë është përcaktuar se: "*1. Zyrtari i lartë nuk ka të drejte: [...] 1.3. të përfaqësosje, ndihmojë ose këshillojë ndonjë person fizik ose juridik, drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet ndonjë personi të afërm ose të besuar, në një konflikt ose marrëdhënie biznesi me institucionin, për detyrën që ai ka kryer ose që është në vazhdimësi të saj për një periudhë deri në dy (2) vite pas përfundimit të funksionit publik; [...]*".

Në rastin konkret, në kuptim dhe zhatim të dispozitës si më lartë, është fakt se ish - zyrtari i lartë z. Nuredin Abazi, në cilësi të avokatit ka përfaqësuar palët në një çështje kontestimore (C.nr.1260/2022) pranë GJTH në Prizren - Dega në Suharekë, pa kaluar dy (2) vite pas mbarimit të funksionit (pensionimit) të tij si gjyqtar i kësaj gjykate, por kufizimi i përcaktuar me dispozitën e sipërcituar nuk vlenë në rastin e tij. Kjo përfaktin se, siç është konstatuar më lartë, së pari z. Nuredin Abazi në cilësi të avokatit nuk ka përfaqësuar palët në një konflikt (kontest) me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik si gjyqtar (GJTH në Prizren - Dega në Suharekë), së dyti lënda (C.nr.1260/2022) për të cilën ish zyrtari në fjalë ka përfaqësuar pranë kësaj gjykate, nuk është lënda (C.nr.493/19) në të cilën ka qenë i angazhuar si gjyqtar.

Rrjedhimisht, z. Nuredin Abazi nuk ka përfaqësuar ndonjë person fizik ose juridik *në një konflikt* me institucionin në të cilin ka ushtruar funksionin si gjyqtar dhe as për *detyrat* përkatësisht lëndën që ai ka kryer në kohën sa ka ushtruar funksionin si gjyqtar. Andaj, Agjencia konstatoi se kufizimi pas mbarimit të funksionit publik sipas nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të LPKI-së, nuk vlenë në këtë rast, pra nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm përkthimin e konfliktit të interesit.

II. Agjencia vendosi si nē pikën II, të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë pér rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se; "Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshire veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.", si dhe paragrafin 15 të këtij nenit, me të cilin është përcaktuar se: "Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative."

Nga sa u tha më lartë, u vendos si nē dispozitiv të këtij vendimi.


Vilim Boleshkai
Drejtori i Agjencisë pér
Parandalimin e Korruptionit

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit z. Skender Kokollari;
- Raportuesit të rastit;
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)